


GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, në trup të përbërë nga gjyqtarët: Naim Kurtishi kryetar, Miftar Shehu dhe Sedat Batjari anëtar, me sekretaren juridike Drita Gëmizaj në çështjen juridike të paditësit D . Sh . nga fsh.B . Komuna e Prizrenit, të cilin e përfaqëson av.B . N . nga Prizreni, kundër të paditurës H . Sh . e lindur L . nga G . Komuna e Suharekës me banim në . Zvicër, për prishjen e kurorës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor jo publik, në prezencën e palëve gjegjësisht të autorizuarve të tyre , me dt.13.10.2016 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **ZGJIDHET ME SHKURORËZIM**, martesa e lidhur në mes të D . Sh . nga fsh.B . Komuna e Prizrenit dhe të paditurës H . Sh . e lindur L . nga G . Komuna e Suharekës, e cila martesë është regjistruar me nr.rendor 43, nr. i ref.24/1993RM/24006 e lidhur me dt. pranë Ofiqarisë të gjendjes civile në H . të Q .
- II. Secila palë i mban shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Pranë kësaj gjykate themelore në Prizren është iniciuar procedura e zgjidhjes së martesës dhe atë me padinë e paditësit D . Sh . nga fsh.B . KK-Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av.B . N . nga Prizreni, kundër të paditurës H . Sh . e lindur L . nga G . KK-Suharekës me banim në . Zvicër, lidhur me zgjidhjen e martesës së tyre. Nga të dhënat e cekura në padi dhe sqarimet të cilat i ka dhënë i autorizuari i paditësit av.B . N . konstatohet fakti se paditësi D . Sh . dhe e paditura H . Sh . e lindur L . kanë lidhur kurorë qysh me dt.06.05.1993 pranë Ofiqarit të gjendjes civile në H . të Q . dhe nga momenti i lidhjes së martesës të njëjtit kanë bashkëjetuar dhe kanë pasur harmoni bashkëshortore. Po ashtu sqarojnë se të njëjtit pra këta bashkëshort në këtë martesë kanë dy fëmijë dhe atë D . Sh . e lindur me . dhe R . Sh . i lindur me . në vazhdim i autorizuari i paditësit ka sqaruar për faktin paditësi dhe e paditura kanë shkëputur bashkësinë martesore dhe atë gjatë viteve 1990 dhe se nuk kanë vënë kurrfarë kontakti në mes tyre andaj nuk ka arsyera që kjo martesë të ngel si e tillë nga se de fakt o e njëjtë ka pushuar. Për këto arsyera i njëjti gjykatës i ka propozuar që të aprovohet kjo këkresë padi meqë janë plotësuar kushtet ligjore ato nga nen 69 të ligjit mbi familjen e Kosovës, e njëherit i njëjti nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.



I autorizuari – përfaqësuesi i përkoshëm i palës së paditur av.E. G. , që eshtë dekluaruar se e konteston në tërësi kërkesë padinë e palës paditëse lidhur me kërkesën për zgjidhjen e kësaj martese ekzistuese në mes të këtyre palëve, mirpo i njëjti nuk jep kurrrafarë arsyetimi në rr Ethanat e kërkesës përfuzimin e kësaj përkësëpadie.

Gjykata në këtë çështje jurudike bëri administrimin e këtyre provave dhe atë: bëri shiqimin dhe leximin e certifikatës së martesës me nr. rendor 43, nr.i ref.24/1993RM/24006, ku vërteton faktin se D. Sh. dhe H. Sh. e lindur L. kanë lidhur kurorë qysh me dt.06.05.1993 pranë Ofiqarit të gjendjes civile në H. të Q. bëhet shiqimi në certifikatën e lindjes së D. Sh. që eshtë me nr. rend.9617 dhe përf. r. Sh. që eshtë me nr. rend.9616, po ashtu i autorizuari i paditësit deklaron se edhe pse eshtë propozuar në padi që do të ndëgjohen dëshmitarët sipas nevojës në rastin konkret nuk ka vend përf administrimin e provave të mëtejshme pasi që nuk eshtë kontestuar fakti se bashkësia martesore nuk ekziston që nga vitet 1990 që nënkupton se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore përzgjidhjen e kësaj martese.

Pas vlerësimit të këtyre provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara, si dhe me aplikimin e dispozitave ligjore ato të parapara me nenin 8 të LPK-ës gjykata ka gjetur se kërkesë padija e paditësit eshtë e bazuar.

Nga provat që janë administruar gjykata ka konstatuar se në këtë çështje juridike janë plotësuar kushtet ligjore përzgjidhjen e kësaj martese nga se marrdhëni bashkëshortore në mes tyre nuk ekzistojnë, dhe se bashkëshortët nuk jetojnë së bashku por të ndarë dhe në të kundërtën marrëdhëni normale bashkëshortore ekzistojnë vetëm atëherë kur bashkëshortët jetojnë në harmoni dhe dashuri kanë respekt në mes veti kanë ndihmë morale dhe materiale dhe dëshirë që këtë bashkësi martesore ta mbajnë përgjithmonë. Pra në të kundërtën pa ekzistimin e këtyre rr Ethanave kemi mohim të bashkësisë martesore dhe largim të njërit prej tjetrit me çka humbet qëllimi i martesës. Në rastin konkret marrëdhëni bashkëshortore në fillim kanë qenë të mira dhe raportet bashkëshortore kanë qenë shembullore por ato para një kohe të gjatë janë acaruar aq shumë sa që paditësi ka filluar të jetoj i ndarë nga paditësja, dhe se nga këto rr Ethanat ka humbur qëllimi i martesës ekzistuese dhe mbajtja në fuqi e këtij statusi martesore e që eshtë faktik dhe jo real eshtë i pa mundshëm e në të kundërtën mbajtja formale e martesës humb efektin e saj dhe përkufizohet liria e personit tjetër në rastin konkret tani paditësit i cili ka interes që të zgjidhet kjo martesë.

Pra nga këto arsyera të lartshënuar dhe me aplikimin e dispozitave ligjore ato të parapara me nenin 69 të Ligjit mbi familjen e Kosovës vërtetohet se janë plotësuar kushtet ligjore përzgjidhjen e kësaj martese meqë janë prezent shkaqet e shkurorëzimit nga se kemi ndërprerje të jetës faktike në mes të paditësit dhe të paditurës përmë shumë se një viti andaj nga këto arsyera ligjore eshtë dashur të vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet eshtë marrë në kuptim të nenit 457 të LPK-ës.

Nga të gjitha këto arsyera, dëfakte të lartpërmendura eshtë vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.



GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.901/15 të dt. 13.10.2016

**Sekretare juridike
Drita Gërmizaj**

**Kryetari i trupit - gjykues
Naim Kurtishi**

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë mbrenda 15 ditësh nga dita e pranimit, ankesa i dorëzohet kësaj gjykate.

Këtë aktgjykim nga originali e vërteton administratori i kësaj gjykate Agron Zylfiu.

